REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK

*Adresa:Lagja "Minatori"* *email:bashkiabulqize@hotmail.com*

Dixhitalizuar ne kuader te Projektit STAR2 permes Qendres per Ceshtjet e Informimit Publik
www.infocip.org
www.vendimeat

**VENDIM**

**Nr 43 Date 3 / 05 /2018**

**PER NJE NDRYSHIM VENDIMI NR.26.DATE.28.02.2018 TE KESHILLI BASHKIAK**

"Bashkia Bulqize i ka kerkuar Keshillit Bashkiak sipas dokumentacionit ligjor, akordimin e ndihmes financiare per rindertim te ures se Zeqanit tek tre Cesmet,Njesia Administrative Zerqan,ure e cila eshte demtuar nga reshjet e rena ne periudhen Nendor-Dhjetor 2017,nga buxheti i Bashkise dhe buxheti i vitit 2018 ne Ministrine e Mbrojtjes,programi "Emergjencat Civile".

**BAZA LIGJORE :**

Ligji 139/2015 "Per VeteqeverisjenVendore",Ligji Nr.107,date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut", Ligjit Nr 8756,date 26.03.2001 "Per EmergjencatCivile",i ndryshuar,VKM Nr. 329,date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore"**Keshilli Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 03.05.2018 pasi diskutoi rreth projektit te paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve dhe Emergjencave Civile dhe Rrugeve Rurale me 16 vota pro,asnje kunder dhe asnje abstenim**

**VENDOSI:**

1.Te miratoje kerkesen e Bashkise Bulqize per mbeshtetje financiare per rindertim te Ures se Zerqanit tre Cezmat, Njesia Administrative Zerqan,Bashkia Bulqize per demtimin e saj nga reshjet e rena.

2.Te miratoje dokumentacionin tekniko-ligjor te hartuar nga Bashkia Bulqize,dhe ndryshimin e vleres se demit te shkaktuar nga 24.661.716 leke qe eshte preventivi i pare i paraqitur ne Keshillin Bashkiak dhe i miratuar me vendimin Nr.26,date 28.02.2018,ne vleren 15.000.000 (pesembedhjete million)leke,kjo sipas preventivit te ndryshuar nga specialistet, bashkangjitur.

3.Ti paraqese dokumentacionin perkates dhe ti kerkoje mbeshtetje Drejtorise se Pergjitheshme te Emergjencave Civile prane Ministrise se Mbrojtjes per ndihme financiare per mbulimin e plote te vleres se demit per rindertimin e ures,sipas preventivit te paraqitur, per shkak te pa mundesise se Bashkise per te mbuluar te gjithe vleren financiare te riparimit te demit te shkaktuar..

4.Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per ndertimin e ures se Zerqanit tek tre Cesmat,Njesia Administrative Zerqan,Bashkia Bulqize.

Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

**PER KESHILLIN BASHKIAK**

**SEKRETARI**
**Agim TUCI**

**KRYETARI**
**Gazmend KENGA**